

**British American Tobacco – Albania Shpk**

**Pasqyrat Financiare**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**  
**(me raportin e audituesve të pavarur)**

## **Përmbajtja**

	<b>Faqja</b>
Raporti i Audituesve të Pavarur	i-iii
Pasqyrat financiare:	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	5-25

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e British American Tobacco Albania Sh.p.k.

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të British American Tobacco Albania Sh.p.k. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar Auditimit (SNRF).

### Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të British American Tobacco Albania Sh.p.k. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, u audituan nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion të pakualifikuar për ato pasqyra në 31 mars 2021.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizem profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është me i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetedijshme e gjithë informacionit, keq përfaqësim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim perfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen British American Tobacco Albania Sh.p.k. përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

## Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2021, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2021 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

Ernst & Young  
31 mars 2022  
Tiranë, Shqipëri




Mario Vangjel  
Auditues Ligjor

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021**


(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënim	2021	2020
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	10	1,937,390	2,015,145
Aktive me të drejtë përdorimi	11	52,584,997	38,431,213
<b>Total i aktiveve afatgjata</b>		<b>54,522,387</b>	<b>40,446,358</b>
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Inventarë	12	588,600,272	556,057,805
Të arkëtueshme tregtare	13	210,069,415	228,414,264
Aktive të tjera	14	97,220,389	112,944,798
Mjete monetare dhe ekuivalentët	15	11,342,858	16,095,069
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>907,232,934</b>	<b>913,511,936</b>
<b>TOTAL I AKTIVEVE</b>		<b>961,755,322</b>	<b>953,958,294</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar	16	552,341,000	552,341,000
Humbjet e mbartura		(72,051,716)	(99,171,744)
<b>TOTAL I KAPITALIT</b>		<b>480,289,284</b>	<b>453,169,256</b>
<b>DETYRIME</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Detyrimet e qirasë	18	37,444,464	22,691,002
Huatë	21	82,594,175	82,594,175
<b>Total i detyrimeve afatgjata</b>		<b>120,038,639</b>	<b>105,285,177</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Të pagueshme tregtare	17	200,556,426	231,193,590
Tatim fitim i pagueshëm		317,913	1,307,584
Detyrimet e qirasë	18	16,457,661	15,960,620
Detyrime të tjera	19	85,633,531	72,220,397
Provizione	20	58,461,867	74,821,670
<b>Total i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>361,427,399</b>	<b>395,503,861</b>
<b>TOTAL I DETYRIMEVE</b>		<b>481,466,038</b>	<b>500,789,038</b>
<b>TOTAL I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>961,755,322</b>	<b>953,958,294</b>

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim nga drejtimi i British American Tobacco-Albania Shpk më 30 mars 2021 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

  
 Administratore  
 Menaxhere e Financës  
 Brunilda Bakiri



  
 Ekzekutive e Financës  
 Jetmira Cukaj

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)*

	<b>Shënim</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Të ardhurat nga kontratat me kliente	22	4,275,318,876	3,208,744,370
Kosto e shitjes	23	(4,054,675,857)	(3,007,328,860)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>220,643,019</b>	<b>201,415,510</b>
Kosto të shpërndarjes	24	(85,169,287)	(90,551,922)
Shpenzime administrative	25	(125,510,973)	(115,369,425)
Të ardhura të tjera operative	26	44,686,836	54,153,405
<b>Rezultati i veprimtarisë operative</b>		<b>54,649,596</b>	<b>49,647,568</b>
Të ardhura financiare		27,265	29,888
Shpenzime financiare		(17,623,630)	(16,135,567)
<b>Shpenzime financiare neto</b>	27	<b>(17,596,365)</b>	<b>(16,105,679)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>37,053,230</b>	<b>33,541,889</b>
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	28	(9,933,203)	(10,672,494)
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>27,120,027</b>	<b>22,869,395</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>27,120,027</b>	<b>22,869,395</b>

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)*

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Humbje të mbartura</b>	<b>Totali i kapitalit</b>
<b>Më 1 janar 2020</b>	<b>552,341,000</b>	<b>(122,041,138)</b>	<b>430,299,862</b>
Fitimi i vitit	-	22,869,395	22,869,395
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>22,869,395</b>	<b>22,869,395</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>552,341,000</b>	<b>(99,171,743)</b>	<b>453,169,257</b>
<b>Më 1 janar 2021</b>	<b>552,341,000</b>	<b>(99,171,743)</b>	<b>453,169,257</b>
Fitimi i vitit	-	27,120,027	27,120,027
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>27,120,027</b>	<b>27,120,027</b>
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>552,341,000</b>	<b>(72,051,716)</b>	<b>480,289,284</b>

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Pasqyrave e fluksve monetare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Shënimi	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2020
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>37,053,230</b>	<b>33,541,889</b>
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime amortizimi	10	936,355	2,277,644
Shpenzime amortizimi aktive me te drejte përdorimi	11	16,858,095	13,544,164
Shpenzim provizioni		-	1,000,250
Provizione të rimarra gjate vitit	20	(16,359,803)	-
Shpenzime interesi	27	14,533,479	14,516,915
Të ardhura nga interesi	27	(27,265)	(29,888)
Shpenzim/(rimarrje) nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare	25	1,041,891	(2,055,256)
Fitimi neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	26	(861,546)	-
Diferencat në përkthimin e këmbimit valutor		(1,319,192)	1,252,098
		<b>51,855,244</b>	<b>64,047,816</b>
<b>Ndryshime në:</b>			
Inventarë		(32,542,467)	(31,094,973)
Të arkëtueshme tregtare		17,302,957	3,433,776
Aktive të tjera		15,724,409	(25,432,016)
Të pagueshme tregtare		(30,637,164)	115,035,943
Detyrime të tjera		13,413,136	(86,320,062)
<b>Flukset e parasë gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>35,116,115</b>	<b>39,670,484</b>
Interes i arkëtuar	27	27,265	29,888
Interes i paguar		(13,204,163)	(14,348,006)
Tatim fitimi i paguar		(10,922,874)	(2,625,888)
<b>Flukset neto të parasë gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>11,016,343</b>	<b>22,726,478</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	10	(858,600)	(1,102,586)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		861,546	-
<b>Flukset neto të parasë përdorur në veprimtaritë investuese</b>		<b>2,946</b>	<b>(1,102,586)</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese</b>			
Shlyerja e detyrimeve të qirasë		(16,213,143)	(12,834,188)
Shlyerja e shpenzimeve të interesit		(1,329,316)	(927,453)
<b>Flukset neto të parasë përdorur në veprimtaritë financuese</b>		<b>(17,542,459)</b>	<b>(13,761,642)</b>
<b>Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to</b>		<b>(6,523,170)</b>	<b>8,789,703</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar		16,095,069	8,557,464
Efkti i ndryshimeve të kursit të këmbimit në mjete monetare dhe ekuivalente me to		1,770,959	(1,252,098)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor</b>	15	<b>11,342,858</b>	<b>16,095,069</b>

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare



# **British American Tobacco – Albania Shpk**

## **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

*(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **1. Entiteti raportues**

British American Tobacco – Albania Shpk (“Shoqëria”) u themelua si një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Tiranë më 15 tetor 2001. Shoqëria zotërohet plotësisht nga British American Tobacco International Holdings B.V. e bazuar në Hollandë. Shoqëria mëmë përfundimtare e Shoqërisë është British American Tobacco plc. (ose “Grupi”), e vendosur në Londër, Mbretëria e Bashkuar.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është importi dhe shitja me shumicë e pakicë e cigareve dhe produkteve të tjera të duhanit me markën e British American Tobacco, në Shqipëri. Shoqëria operon në kuadër të strategjisë dhe objektivave të Grupit për Shqipërinë dhe rajonin e Ballkanit duke përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë. Furnitorët dhe financuesit kryesorë të Shoqërisë janë Shoqëri brenda Grupit (shih shënimin 30). Zyra e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Rrugën e Kavajës, Ish Kombinati Ushqimor, Tiranë, Shqipëri. Më 31 dhjetor 2021, Shoqëria ka të punësuar 14 punonjës (31 dhjetor 2020: 13 punonjës).

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17 datë 16.01.2019, në mbështetje të ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009, një njësi ekonomike mund të klasifikohet si njësi ekonomike me interes publik (NIP) për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punonjësve të tyre. Kompania është klasifikuar si NIP për shkak të përmbushjes së kriterëve të madhësisë së totalit të aktiveve dhe të ardhurave për vitin.

### **2. Bazat e kontabilitetit**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK)..

### **3. Baza e matjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### **4. Monedha funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në lek Shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **5. Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë, i cili është supozimi se Shoqëria do të mbetet në biznes për një të ardhme të parashikueshme dhe do të jetë në gjendje të njohë aktivitetet e saj dhe të shlyejë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit. Bazuar në buxhetin e aprovuar, Shoqëria planifikon të rrisë aktivitetin e saj operacional dhe rezultatet pozitive parashikohen në vitin e ardhshëm.

Më 31 Dhjetor 2021, Shoqëria kishte grumbulluar humbje prej 72,051,716 Lek (2020: 99,171,743Lek), kryesisht si rezultat i humbjeve të gjeneruara në vitet paraprake kur ishte në fazën fillestare. Gjatë vitit 2021 dhe 2020, Shoqëria ka qenë fitimprurëse. Shoqëria pret që të ardhurat të rriten më tej në 2022. Gjatë vitit 2021, Shoqëria gjeneroi fluks neto pozitiv të parasë nga aktivitetet e saj operative prej 10,290,238 lekë (2020: fluksi neto pozitiv te parase prej 22,726,478 lekë).

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

### **6. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi pasiguritë lidhur me vlerësimet dhe gjykimet të cilat kanë efekt të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare është përshkruar në paragrafin e mëposhtëm si dhe në shënimet e mëposhtme.

## **British American Tobacco – Albania Shpk** **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

*(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **6. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

#### **A. Gjykime**

Shënimi 7 (e) – Të arkëtueshmet tregtare të cilat kërkojnë gjykim në lidhje me zbritjen për humbje të pritshme të kreditorëve.

Shënimi 7 (i) – Njohja e të ardhurave: nëse të ardhurat do të njihen në një moment të caktuar kohor apo përgjatë periudhës.

#### **B. Supozimet dhe paqartësitë e vlerësimit**

Shënimi 7 (i) – Njohja e të ardhurave: Vlerësimi i kthimeve të pritura.

Shënimi 7 (e) – Matja e zbritjes për Humbje të Pritshme Kreditorë (HPK-ve) për të arkëtueshmet tregtare.

Shënimi 7 (h) - Afati i qirasë: nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme për të ushtruar opsionin për të zgjatur periudhën e qirasë.

### **7. Përmbledhja e politikave kontabël**

Kompania ka zbatuar vazhdimisht politikat kontabël të mëposhtme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç nëse përmendet ndryshe.

#### **a) Konvertimi i monedhave të huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportit. Fitimet ose humbjet nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit, njihen në fitim ose humbje.

#### **b) Aktivitetet afatgjata materiale**

Aktivitetet afatgjata materiale (pajisjet) mbahen me kosto historike zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka të tilla. Kosto historike përfshijnë shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitetit afatgjatë material ose njihen si aktiv më vete vetëm nëse është e mundur që Shoqëria të ketë përfitim të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivitetin në fjalë dhe kostoja e tij të mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjithë shpenzimet e tjera të mirëmbajtjeve dhe riparimeve njihen në fitim ose humbje në momentin që ato ndodhin.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale njihen neto në zërin 'Të ardhura të tjera operacionale' në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi përlogaritet për të zvogëluar koston e aktiveve afatgjata materiale zbritur vlerën e tyre të mbetur, duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së tyre të dobishme, dhe përgjithësisht njihet në fitim ose humbje. Zhvlerësimi fillon të njihet në ditën e pare të muajit pas atij të blerjes. Jetët e dobishme të vlerësuara janë si në vijim:

<b>Përshkrimi i kategorisë</b>	<b>Vitet</b>
Pajisje zyre dhe mobilje	5
Pajisje IT	4
Mjete transporti	5

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktivitetit rishikohen dhe nëse është e nevojshme, rregullohen në çdo datë raportimi.

#### **c) Inventarët**

Inventarët maten me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve llogaritet me metodën FIFO (first-in, first-out) dhe përfshijnë koston e blerjes, taksa e detyrime të pa rimbursueshme dhe kosto të tjera të kryera për sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen e gatshme për përdorim. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit, minus koston e vlerësuar të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

## **British American Tobacco – Albania Shpk** **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

*(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **d) Instrumentet financiarë**

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiarë jo derivative.

*(i) Aktivet dhe detyrimet financiare jo derivativë – Klasifikimi dhe matja*

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGj - investim në instrumente borxhi; VDATGj - investim në instrumente të kapitalit neto; ose VDPFH. Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përjashtuar rastin kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për drejtimin e aktiveve financiare, rast kur riklasifikohen të gjitha aktivet e ndikuara.

Në njohjen fillestare të një investimi në instrumente të kapitalit neto që nuk mbahet për shitje, Shoqëria mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë të investimit në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGj). Ky vendim merret individualisht për çdo investim. Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv mbahet në nivel portofoli pasi kjo reflekton më së miri mënyrën se si drejtohet biznesi dhe informacionin që i ofrohet drejtimin. Informacioni përfshin:

Aktivitetet financiare - Vlerësimi i modelit të biznesit:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimi i këtyre politikave në praktikë. Këtu përfshihet nëse strategjia e drejtimin përqendrohet në fitimin e flukseve monetare kontraktuale, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e ndonjë detyrimi të lidhur ose daljen e flukseve monetare ose duke realizuar flukset e mjeteve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet drejtimin të Shoqërisë
- rreziqet që ndikojnë performancën e modelit të biznesit (dhe aktivitetet financiare të mbajtura në këtë model biznesi) dhe si menaxhohen rreziqet.
- frekuenca, sasia dhe koha e shitjes së aktiveve financiare në periudha të mëparshme, arsyet e shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjes

Shoqëria fillimisht njeh huatë dhe të arkëtueshmet me datën e origjinës. Të gjithë aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur Shoqëria bëhet palë kontraktuale e një instrument. Shoqëria ç'regjistron aktivet financiare nëse të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar perfundojnë, ose nëse Shoqëria i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale nga aktiviteti financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete. Shoqëria ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përbushur, ndërprerë apo përfunduar. Aktivitetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pozicionin financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto të drejtpërdrejtë të transaksionit. Pas njohjes fillestare, ato mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga zhvlerësimi (shih shënimin 7 (e)(i)). Detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus çdo kosto të drejtpërdrejtë të transaksionit. Pas njohjes fillestare, këto detyrime mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare është paraqitur në politikën kontabël 7 (k).

#### **e) Zhvlerësimi**

*(i) Aktive financiare*

Shoqëria njeh zbritje për humbjet e pritshme kreditore (HPK) për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Zbritja e humbjeve për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare maten gjithmonë me vlerën e barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë gjithë jetës së aktivitetit. Gjatë vlerësimit nëse rreziku kreditor i një aktiviteti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe gjatë vlerësimit të humbjes së pritshme kreditore, Shoqëria konsideron informacione të arsyeshme të cilat janë të disponueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta. Kjo përfshin informacionin cilësor dhe sasior, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë, vlerësimin e kredisë dhe informacionin për të ardhmen. Pas njohjes fillestare, provizioni për humbjet e pritshme kreditore (HPK) njihet në aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDAGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

## **British American Tobacco – Albania Shpk** **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

*(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **e) Zhvlerësimi (vazhdim)**

##### *i) Aktive financiare (vazhdim)*

SNRF 9 lejon zbatimin e një "metode të thjeshtuar" për të arkëtueshmet tregtare. Metoda e thjeshtuar lejon njohjen e humbjeve të pritshme gjatë gjithë jetës për të arkëtueshmet pa pasur nevojë të identifikohen rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë. Për të arkëtueshmet tregtare, Shoqëria aplikon një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e HPK-ve. Prandaj, Shoqëria nuk gjurmon ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njuh një provigjon për humbje bazuar në HPK-të gjatë gjithë jetës në çdo datë raportimi. Normat e pritshme të humbjeve të kredisë dhe matrica e zhvlerësimit bazohen në politikën e shoqërisë mëmë.

Që nga prilli 2020, për shkak të Covid 19, përqindjet aktuale të matricës së provizioneve SNRF 9 janë rritur. Sipas politikës, për vlerësimin e borxhit të keq aplikohen përqindje të caktuara që variojnë nga 0.1% e vlerës së faturës për artikujt e papaguar por jo të vonuar deri në 0.20% të vlerës së faturës për artikujt mbi 12 muaj të vonuar. Nëse provizionin për klientët individualë duhet të rritet përtej nivelit të matricës, atëherë provizionin shtesë njihet në llogarinë specifike të provizionit të borxhit të keq.

##### *Fshirja*

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të tij. Shoqëria nuk pret rikuperim të konsiderueshëm nga shuma e fshirë. Megjithatë, aktivet financiare të ç'regjistruara mund të mbeten objekt i aktiviteteve përbarimore për të qenë në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave për t'u arkëtuar.

##### *(ii) Aktivitet jo-financiare*

Vlerat kontabël të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka tregues të tillë, atëherë çmohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot për t'u shitur. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontoohen për të dhënë vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit. Me qëllim testimit për zhvlerësim, aktivitet grupohen së bashku në njësinë më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm që janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo grupeve të tjera të aktiveve ("njësi gjeneruese e mjeteve monetare"). Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare e tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me një njësi gjeneruese të mjeteve monetare shpërndahen për të zvogëluar vlerën e mbartur të aktiveve në njësi (grup njësisish) në varësi të peshës së secilit. Humbja nga zhvlerësimi rishikohet në çdo datë raportimi për tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi rimerret nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën në të cilën vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij, që përcaktohet nga vlera neto e tij pas amortizimit, nëse nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

#### **f) Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

#### **g) Provizionet**

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohej një fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare më një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi kohor i skontimit njihet si kosto financiare.

## **British American Tobacco – Albania Shpk** **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### **7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **h) Qiratë**

##### *(i) Aktive me të drejtë përdorimi*

Shoqëria merr me qira ndërtesa që përdoren si zyra dhe magazina, si dhe automjete që përdoren për qëllime të veprimtarisë së saj ekonomike.

Aktivitet me të drejtë përdorimi maten me kosto, zbritur çdo zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, dhe rregullohen për çdo rimatje të detyrimeve të qirasë.

Kostoja e aktiveve me të drejtë përdorimi përfshin:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë qiraje e bërë në ose përpara datës së fillimit minus çdo stimul qiraje të marrë;
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për rikthimin e aktivitet në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë.

##### *Amortizimi*

Aktivitet me të drejtë përdorimi në përgjithësi amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër të jetës së dobishme të aktivitet dhe afatit të qirasë në bazë të metodës lineare. Nëse Shoqëria është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të ushtrojë një opsion blerjeje, aktivitet i së drejtës së përdorimit amortizohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve bazë. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi të lidhur me ndërtesat dhe automjetet llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi kushtet e kontratës së qirasë.

	<u>Jeta e dobishme në vite</u>
Ndërtesa	3
Automjetet	5

##### *(ii) Detyrimet e qirasë*

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njihet detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të bëhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë:

- pagesat fikse (përfshirë pagesat fikse në thelb), zbritur çdo insentivë qiraje të arkëtueshme,
- pagesa e ndryshueshme e qirasë që bazohet në një indeks ose një normë, të matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit,
- shumat që priten të paguhet nga Shoqëria nën garancitë e vlerës së mbetur,
- çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Shoqëria është e sigurt në mënyrë të arsyeshme se do ta ushtrojë atë opsion., dhe
- pagesat e penaliteteve për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron shoqërinë që e ushtron këtë opsion.

Pagesat e qirasë skontohej duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Norma mesatare rritëse e huamarrjes për kontratat e reja në vitin 2021 është 4.50%. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, përdoret norma rritëse e huamarrjes së Shoqërisë, që është norma që Shoqëria do të duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivin e të drejtës së përdorimit në një aktiv të ngjashëm ekonomik. mjedis me kushte, kolaterale dhe kushte të ngjashme.

Për përcaktimin e normës rritëse të huamarrjes, Shoqëria aplikon normën e publikuar nga Banka e Shqipërisë për huamarrjet në euro për pasuri të paluajtshme dhe blerje pajisjesh, me afat maturimi nga 3 deri në 5 vjet. Pagesat e qirasë gjatë gjithë periudhës 5-vjeçare të kontratës për ndërtesat janë të ndryshueshme dhe variojnë në bazë të çmimit për metër katror të rënë dakord nga palët, duke marrë parasysh çmimet e referencës për dhënie me qira të ndërtesave për qëllime tatimore, sipas legjislacionit përkatës. Pagesat e qirasë për kontratën e automjetit janë pagesa mujore fikse.

Pas datës së fillimit, shuma e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar rritjen e interesit dhe reduktohet për pagesat e qirasë të bëra.

## **British American Tobacco – Albania Shpk** **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

*(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **h) Qiratë (vazhdim)**

*(ii) Detyrimet e qirasë (vazhdim)*

Përveç kësaj, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë rimatet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa të qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë aktivin bazë. Pagesat e qirasë shpërndahen ndërmjet principalit dhe kostove financiare. Kostot financiare ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë periodike konstante interesi për tepricën e mbetur të detyrimit për çdo periudhë. Asetet e mbajtura nën qira të tjera klasifikohen si qira operative dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në fitim ose humbje mbi bazën lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë. Incentivat e marra të qirasë njihen si pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

#### **i) Të ardhurat**

Të ardhurat njihen në shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma që Shoqëria pret të rimbursojë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat ose shërbimet e premtuara për një klient.

*Shitja e mallrave*

Shoqëria shet një sërë produktesh duhani në tregun me shumicë. Shitjet njihen kur mallrat i dorëzohen shitësit me shumicë (këtej e tutje: distributori). Distributori merr kontrollin e produkteve kur mallrat dorëzohen dhe janë pranuar në ambientet e tyre. Shoqëria njeh të ardhurat nga shitja e mallrave në një moment në kohë.

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme nga mallrat dhe shërbimet e shitura në rrjedhën e zakonshme të biznesit të Shoqërisë.

Të ardhurat paraqiten me vlerën e tyre neto nga TVSH-ja, kthimet dhe zbritjet. Shoqëria njeh të ardhurat kur shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që shoqëria të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe kur përmbushen disa kriteret e tilla si përshkruhen më poshtë. Shitjet regjistrohen me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes, para zbritjes së kompensimit tregtar në momentin e shitjes. Përvoja e akumuluar është përdorur për të vlerësuar dhe siguruar zbritjen e kompensimit tregtar.

*Shuma korresponduese e ndryshueshme*

Nëse shuma korresponduese e premtuar në një kontratë përfshin një shumë të ndryshueshme, njësia ekonomike duhet të vlerësojë shumën korresponduese për të cilën njësia ekonomike do të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave apo shërbimeve tek një klient. Shuma korresponduese e ndryshueshme vlerësohet në fillimin e kontratës dhe kufizohet deri në masën që ka shumë mundësi që zgjidhja e mëpasshme e pasigurisë lidhur me shumën e ndryshueshme nuk do të sjellë anulim të rëndësishëm të shumës së të ardhurave të akumuluar të njohura.

Shoqëria aplikon disa zbritje kontraktuale në lidhje me faturimin e periudhës dhe objektivat kryesorë të performancës, të cilat japin një shumë korresponduese të ndryshueshme. Të ardhurat nga shitjet me zbritje njihen bazuar në çmimin e specifikuar në kontratë, neto nga zbritjet e vëllimit të vlerësuar. Përvoja e akumuluar përdoret për të vlerësuar dhe parashikuar zbritjet, duke përdorur metodën e vlerës së pritur, dhe të ardhurat njihen vetëm në masën që është shumë e mundshme që të mos ndodhë një anulim i rëndësishëm i të ardhurave të akumuluar të njohura. Një detyrim njihet për çdo zbritje që lidhet me vëllimin, i pagueshëm për klientët në lidhje me shitjet e bëra deri në fund të periudhës së raportimit, nëse nuk është faturuar ende. Zbritjet njihen plotësisht brenda periudhës.

## **British American Tobacco – Albania Shpk** **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

*(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **i) Të ardhurat (vazhdim)**

*Shuma korresponduese e ndryshueshme (vazhdim)*

Marrëveshja për shitjen e mallrave u siguron klientëve të drejtën për t'i kthyer mallrat brenda një periudhe të caktuar. Të drejtat e kthimit shkaktojnë shuma të ndryshueshme, megjithatë në vitet e fundit Shoqëria nuk ka patur kthime të mallrave.

Asnjë element financimi nuk konsiderohet i pranishëm pasi shitjet kryhen me një afat kredie nga 0-40 ditë, që është në përputhje me praktikën e tregut. Një llogari e arkëtueshme njihet kur mallrat dorëzohen pasi kjo është momenti në të cilin shuma është e pakushtëzuar sepse kërkohet vetëm kalimi i kohës përpara se të bëhet pagesa.

*Komponenti i rëndësishëm financiar*

Shoqëria nuk pret të ketë kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të mallrave të premtuara klientit dhe pagesës nga klienti të kaloj një vit. Rrjedhimisht, Shoqëria nuk rregullon asnjë nga çmimet e transaksionit për vlerën në kohë të parasë.

*Rimbursime te shpenzimeve per hapësire reklamimi*

Rimbursimet per programet e hapësires reklamuese per te promovuar shitjen e produkteve te licensuara llogariten si zbritje nga te ardhurat ne vitin ne te cilin jane kryer shpenzimet perkatese.

#### **j) Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Shoqëria paguan kontribute fikse për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve të saj mbi daljen në pension. Detyrimet për kontribute në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet, në bazë të një plani kontributesh të përcaktuara.

*Përfitimet afatshkurtra*

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve vlerësohen të paskontuara dhe njihen si shpenzim kur shërbimi përkatës kryhet. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet sipas përfitimeve afatshkurtra apo planeve për ndarjen e fitimit, nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara, të kryera nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

#### **k) Të ardhurat dhe kostot financiare**

Të ardhurat financiare dhe kostot financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi, shpenzimet e interesit dhe fitimet ose humbjet nga veprimet në monedhë të huaj. Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi në monedha të huaja paraqiten në shumën neto.

#### **l) Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveçse kur lidhen me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

*(i) Tatim fitim aktual*

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar nga të ardhurat e tatueshme ose humbja për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të cilat hyjnë në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

## **British American Tobacco – Albania Shpk** **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

*(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **7. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **l) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

##### *(ii) Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose të cilat miratohen deri në datën e raportimit financiar.

Aktivet për tatime të shtyra njihen vetëm deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të realizohet.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore paraqiten neto, në qoftë se ka një të drejtë ligjore për të netuar aktivet dhe detyrimet aktuale tatimore, dhe ato lidhen me tatime mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor, për të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet aktuale tatimore në bazë neto, ose aktivet dhe detyrimet tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Në përcaktimin e vlerës së tatim fitimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr parasysh impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse taksa dhe interesa shtesë mund të jenë të pagueshme. Shoqëria beson se përllogaritjet për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet, bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në llogaritje dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacioni i ri mund të vihet në dispozicion dhe mund të shkaktojë që Shoqëria të ndryshojë gjykimet në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të kenë impakt mbi tatim fitimin në periudhat që bëhet ky përcaktim.

### **8. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të reja dhe të rishikuara të raportimit financiar**

#### *(i) Standardet e nxjerra dhe efektive për periudhën aktuale*

Disa ndryshime dhe interpretime zbatohen për herë të parë në vitin 2021, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **Reforma e normës së interesit – Faza 2**– Ndryshime në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16
- **Koncesionet e qirave të lidhura me Covid-19** përtej 30 qershorit 2021 amendim i në SNRF 16

#### *(ii) Standardet dhe Amendamentet e lëshuara por ende të paaplikueshme dhe të pa miratuara më herët*

Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme do të miratohen nga Shoqëria kur të hyjnë në fuqi, megjithatë, këto nuk do të kenë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 14 “Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore”** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2016 ose pas) - Komisioni Evropian ka vendosur të mos nisë procesin e miratimit të këtij standardi të ndërmjetëm dhe të presë për standardin përfundimtar;
- **Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”**- Klasifikimi i Detyrimeve si Aktuale ose Jo Aktual (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023);
- **Ndryshime në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare”**- Shpalosja e Politikave Kontabël (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2023 ose pas);
- **Ndryshime në SNK 8 “Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet”**- Përkufizimi i vlerësimeve kontabël (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023);
- **Ndryshimet në SNK 12 “Tatimet mbi të Ardhurat”** - Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023);



## **British American Tobacco – Albania Shpk** **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

*(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **8. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të reja dhe të rishikuara të raportimit financiar (vazhdim)**

*(ii) Standardet dhe Amendamentet e lëshuara por ende të paaplikueshme dhe të pa miratuara më herë*

- **Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta”**- Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshime të mëtejshme (data në fuqi shtyhet për një kohë të pacaktuar deri në projektin e kërkimit në është përfunduar metoda e kapitalit neto);
- **Ndryshime në SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”**- Zbatimi fillestar i SNRF 17 dhe SNRF 9 – Informacion Krahasues (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023).

### **9. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut**

**(a) Vlera e drejtë,**

Një sërë politikash kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të Kompanisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktivet ashtu edhe për detyrimet financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose dhënie informacionesh shpjeguese bazuar në metodat e mëposhtme. Aty ku është e aplikueshme, informacione të mëtejshme rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë shpaloset në shënimet specifike për atë aktiv ose pasiv.

*Aktivet financiare jo-derivativë*

Të arkëtueshmet tregtare paraqiten neto nga provizionet për zhvlerësim. Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

*Detyrime financiare jo-derivativë*

Vlera e drejte e cila është përcaktuar për qëllime prezantimi, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme të principalit dhe të interesit, të aktualizuara me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Vlera kontabël e huave dhe detyrimeve të tjera përafrohet me vlerën e tyre të drejtë për shkak të afatit të tyre të shkurtër të maturimit.

**(b) Administrimi i rrezikut financiar**

Administrimi i rrezikut financiar është element thelbësor në aktivitetin e Shoqërisë. Rreziqet më të mëdha ndaj të cilave Shoqëria është e ekspozuar janë si në vijim:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit; dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe administrimin e rrezikut dhe administrimin e kapitalit.

*(i) Kuadri i administrimit të rrezikut*

Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë kanë për qëllim të identifikojnë, analizojnë dhe menaxhojnë rrezikun me të cilin përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollat e duhura për rreziqet, dhe monitoruar vazhdimisht nivelet e rrezikut dhe përputhshmërinë me limitet. Politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara dhe dhe praktikatat më të mira në zhvillim.

## British American Tobacco – Albania Shpk Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 9. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (Vazhdim)

#### (b) Administrimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

##### (i) Kuadri i administrimit të rrezikut (Vazhdim)

Drejtimi i Shoqërisë në bashkëpunim me strukturat e administrimit të rrezikut të grupit dhe të mbikëqyrur nga grupi, ka përgjegjësi mbi mbikëqyrjen e kuadrit të administrimit të rrezikut, duke mbikëqyrur administrimin e rreziqeve kryesore, duke rishikuar politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut si dhe duke aprovuar transaksionet që përfshijnë shuma të rëndësishme. Funkzioni i administrimit të rrezikut brenda Shoqërisë i referohet administrimit të rrezikut financiar, rrezikut operacional dhe rrezikut ligjor. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikun kreditor dhe rrezikun e likuiditetit. Objektivat kryesore të administrimit të rrezikut financiar janë përcaktimi i limiteve të rrezikut, dhe të sigurojë që ekspozimi ndaj rreziqeve të jetë brenda këtyre limiteve. Administrimi i rrezikut operacional dhe rrezikut ligjor synojnë të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, për të minimizuar rreziqet operationale dhe ligjore. Faktorët e rrezikut të jashtëm dhe të brendshëm identifikohen dhe administrohen përmes strukturës organizative të Shoqërisë dhe veçanërisht nga strukturat e administrimit të rrezikut në nivel grupi.

##### (ii) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë. Klienti i vetëm i Shoqërisë ("Klienti"), është një Shoqëri vendase e shitjes me shumicë. Ekspozimi i Shoqërisë kundrejt rrezikut kreditor ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të Klientit të saj.

Pas datës së raportimit, Shoqëria ka arkëtuar të gjithë shumën e mbetur të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe nuk pret ndonjë humbje nga mospagimi. Klienti ka ofruar një garanci bankare prej 2,750,000 Euro, e vlefshme deri më 31 dhjetor 2022, për të garantuar të arkëtueshmet. Sipas kontratës midis palëve, kjo garanci do të jetë në fuqi përgjatë gjithë periudhës së kontratës.

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut kreditor reflektohet në vlerën kontabël të aktiveve.

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Të arkëtueshme tregtare (Shënimi 13)	210,069,415	228,414,264
Të arkëtueshme të tjera (Shënimi 14)	43,807,381	44,072,860
Mjete monetare dhe ekuivalente me to (Shënimi 15)	11,342,858	16,095,069
	<b>265,219,655</b>	<b>288,582,193</b>

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, analiza e vjetërsisë së të arkëtueshmeve është si në vijim:

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Pa vonesa	211,476,762	263,571,294
Kthim / Zbritje për zhvlerësim	-	(34,791,575)
Zbritje për humbjet e pritshme kreditore	(1,407,346)	(2,420,710)
	<b>210,069,415</b>	<b>229,792,785</b>

Provizioni për zhvlerësim në lidhje me mallrat e vjetëruara dhënë klientit në vlerën 34,791,575 Lek është fshirë gjatë vitit 2021 pas përfundimit të asgjësimit të mallrave të vjetëruara.

Shoqëria ka përcaktuar se nuk ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare dhe ka vlerësuar se portofoli i të arkëtueshmeve tregtare, të cilat janë zëra të papaguar, por jo të vonuar, ka një humbje mesatare të mospagimit ('HMM') prej 0.1%. Drejtimi e konsideroi vlerën e lejimit të humbjeve të kredisë për vitin jo materiale, pa pasur nevojë për një shpalosje të detajuar.

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**9. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (Vazhdim)**

**(b) Administrimi i rrezikut financiar (Vazhdim)**

*(iii) Rreziku i likuiditetit*

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Përjasja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurojë, sa më shumë që të jetë e mundur, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj kur ato maturohen, në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar reputacionin e saj.

Zakonisht Shoqëria sigurohet se ka likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet e pritshme operationale, duke përfshirë shlyerjen e detyrimeve financiare; kjo përjashton ndikimin potencial të rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, të tilla si katastrofat natyrore.

Struktura e maturitetit të detyrimeve financiare të Shoqërisë në bazën e pagesave kontraktuale të paskontuara është prezantuar si më poshtë:

	<b>Më pak se 3 muaj</b>	<b>Midis 3 muaj dhe 1 vit</b>	<b>Midis 1 dhe 3 vite</b>	<b>Totali</b>
<b>31 dhjetor 2021</b>				
<b>Detyrimet financiare</b>				
Huatë	-	-	81,920,000	<b>81,920,000</b>
Të pagueshme tregtare	200,556,426	-	-	<b>200,556,426</b>
Të pagueshme ndaj personelit dhe shpenzime të llogaritura (shënimi 19)	84,424,131	-	-	<b>84,424,131</b>
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>284,980,557</b>	-	<b>81,920,000</b>	<b>366,900,557</b>
<b>31 dhjetor 2020</b>				
<b>Detyrimet financiare</b>				
Huatë	-	-	81,920,000	<b>81,920,000</b>
Të pagueshme tregtare	231,193,590	-	-	<b>231,193,590</b>
Të pagueshme ndaj personelit dhe shpenzime të llogaritura (shënimi 19)	71,667,282	-	-	<b>71,667,282</b>
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>302,860,872</b>	-	<b>81,920,000</b>	<b>384,780,972</b>

*(iv) Rreziku i tregut*

Rreziku i tregut është rreziku që lëvizjet në çmimet e tregut, duke përfshirë edhe kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës dhe rrezikun e normës së interesit, meqenëse Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj instrumenteve të kapitalit dhe rreziqeve të lidhura me to.

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**9. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)**

**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

*(iv) Rreziku i tregut (vazhdim)*

Rreziku i tregut rrjedh nga pozicionet e hapura në normat e interesit dhe në monedhë të huaj që janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve specifike dhe të përgjithshme të tregut dhe ndryshimit në nivelin e paqëndrueshmërisë të çmimeve të tregut. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është për të administruar dhe kontrolluar ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, në optimizmin e kthimit.

*Rreziku i monedhës*

Shoqëria ka aktive dhe detyrime të shprehura në Euro. Rreziku i monedhës së huaj lind kur aktivet aktuale ose të parashikuara në një monedhë të huaj janë ose më të mëdha, ose më të vogla se detyrimet në këtë monedhë. Ndikimi i rrezikut të normës së këmbimit valutor mbi Shoqërinë është kufizuar në monedhën Lek dhe Euro. Kurset më të rëndësishme të këmbimit kanë qenë si më poshtë:

Lek	Kursi mesatar	Kursi në datën e raportimit
	2021	2021
<b>EUR 1</b>	122.44	120.76
<b>GBP 1</b>	142.44	143.95
	2020	2020
<b>EUR 1</b>	123.77	123.70
<b>GBP 1</b>	139.26	137.93

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj bazuar në shuma nominale është si në vijim:

	Lek	EUR	GBP	Totali
<b>31 Dhjetor 2021</b>				
<b>Aktive Financiare</b>				
Të arkëtueshme tregtare	210,069,415	-	-	<b>210,069,415</b>
Të arkëtueshme të tjera	-	43,807,381	-	<b>43,807,381</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	999,440	10,343,419	-	<b>11,342,858</b>
	<b>211,068,855</b>	<b>54,150,799</b>	-	<b>265,219,655</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Të pagueshme tregtare	7,036,083	117,482,273	-	<b>124,518,356</b>
Hua	82,594,175	-	-	<b>82,594,175</b>
	<b>89,630,258</b>	<b>117,482,273</b>	-	<b>207,112,531</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>121,438,597</b>	<b>(63,331,473)</b>	-	<b>58,107,123</b>
<b>31 Dhjetor 2020</b>				
<b>Aktive Financiare</b>				
Të arkëtueshme tregtare	228,414,264	-	-	<b>228,414,264</b>
Të arkëtueshme të tjera	-	44,072,860	-	<b>44,072,860</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	15,988,981	106,088	-	<b>16,095,069</b>
	<b>244,403,245</b>	<b>44,178,948</b>	-	<b>288,582,193</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Të pagueshme tregtare	155,421,724	74,856,067	915,799	<b>231,193,591</b>
Hua	82,594,175	-	-	<b>82,594,175</b>
	<b>238,015,900</b>	<b>74,856,067</b>	<b>915,799</b>	<b>313,787,766</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>6,387,345</b>	<b>(30,677,119)</b>	<b>(915,799)</b>	<b>(25,205,573)</b>

Shoqëria përdor funksionin e thesarit të grupit për të zbutur rrezikun që vjen nga transaksionet tregtare të shprehura në monedha të huaja.

## British American Tobacco – Albania Shpk Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 9. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

#### (b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

##### (iv) Rreziku i tregut (vazhdim)

#### Analiza e ndjeshmërisë

Një forcim apo dobësim i lekut, si tregohet më poshtë, kundrejt Euros dhe GBP në 31 dhjetor do të ndikojë respektivisht në zvogëlim ose rritje të kapitalit dhe fitim/humbjes me shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë bazohet në luhatshmërinë e normave të kurseve të këmbimit dhe një lëvizje prej 10% konsiderohet e arsyeshme nga Shoqëria në fund të periudhës raportuese.

në Lek	31 Dhjetor 2021		31 Dhjetor 2020	
	Kapitali	Fitimi/humbja	Kapitali	Fitimi/humbja
EUR	(5,383,175)	(5,383,175)	(2,607,555)	(2,607,555)
GBP	-	-	(77,843)	(77,843)

#### Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që lëvizjet në normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e portofolit të instrumenteve financiarë. Duke qenë se Shoqëria nuk ka aktive që mbartin rrezik të rëndësishëm, të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset operative janë kryesisht të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë kryesisht në huamarrjet me normë interesi fikse, duke ndryshuar vlerën e tyre të drejtë.

Drejtimi nuk ka një politikë formale që përcakton se sa huamarrje duhet të jenë me normë interesi fikse apo të ndryshueshme. Megjithatë, kur merren hua të reja drejtimi përdor gjykimin e tij për të vendosur nëse beson se një normë interesi fikse ose e ndryshueshme do të jetë më e përshtatshme për Shoqërinë gjatë periudhës së pritshme deri në maturim.

Profili i normës së interesit që mban Shoqëria për instrumentet financiare mbartëse të interesit në datën e raportimit është si më poshtë:

	Vlera e mbetur më 31 dhjetor	
	2021	2020
Huatë (normat e ndryshueshme)	82,594,175	82,594,175
	<b>82,594,175</b>	<b>82,594,175</b>

Më 31 dhjetor 2021, një rritje (rënie) e mundshme e arsyeshme me 100 pikë bazë në normat e interesit, me të gjithë faktorët e tjerë të mbajtur të pandryshuar, do të kishte një rënie (rritje) të kapitalit dhe fitimit ose humbjes para tatimit me 825,942 Lekë (2020: 825,942 Lekë).

#### (v) Administrimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë në administrimin e kapitalit janë ruajtja e aftësisë së Shoqërisë sipas parimit të vijimësisë në mënyrë që të sigurojë një fitim për pronarët dhe të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e tij. Kostoja totale e kapitalit llogaritet si pjesa e kapitalit të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si totali i huave paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar minus mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre. Për të ruajtur apo përshtatur strukturën e kapitalit, Grupi mund të përshtatë sasinë e dividendit të paguar aksionarëve ose mund të nxjerrë aksione të reja apo të shesë aksione për të zvogëluar borxhet.

Shoqëria është financuar me kapital dhe kryesisht me financime nga palët e lidhura. Politikat e zbatuara synojnë që Shoqëria të jetë në gjendje të paguajë borxhet dhe detyrimet në lidhje me shpenzimet në investimet kapitale kur ato maturohen. Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë kërkese të jashtme lidhur me kapitalin.

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**10. Aktivet afatgjata materiale**

	Pajisje zyre dhe mobilje	Pajisje IT	Mjete transporti	Totali
<b>Kosto</b>				
Më 1 janar 2020	9,692,528	22,461,857	27,318,471	59,472,856
Shtesa	-	1,102,587	-	1,102,587
Pakësime	-	(4,758,860)	-	(4,758,860)
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>9,692,528</b>	<b>18,805,584</b>	<b>27,318,471</b>	<b>55,816,583</b>
Shtesa	-	858,600	-	858,600
Pakësime	-	-	(8,475,329)	(8,475,329)
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>9,692,528</b>	<b>19,664,184</b>	<b>18,843,142</b>	<b>48,199,854</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
Më 1 janar 2020	(9,115,122)	(21,322,236)	(25,845,295)	(56,282,653)
Shpenzime të vitit	(43,149)	(761,320)	(1,473,175)	(2,277,645)
Pakësime	-	4,758,860	-	4,758,860
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(9,158,271)</b>	<b>(17,324,696)</b>	<b>(27,318,471)</b>	<b>(53,801,438)</b>
Shpenzime të vitit	(534,257)	(402,098)	-	(936,355)
Pakësime	-	-	8,475,329	8,475,329
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>(9,692,528)</b>	<b>(17,726,794)</b>	<b>(18,843,142)</b>	<b>(46,262,465)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
Më 1 janar 2020	577,406	1,139,621	1,473,176	3,190,203
Më 31 dhjetor 2020	534,257	1,480,888	-	2,015,145
Më 31 dhjetor 2021	-	1,937,390	-	1,937,390

Shpenzimet e amortizimit janë përfshirë në shpenzimet tregtare si dhe në shpenzimet administrative në fitim ose humbje, të ndara sipas qendrave të kostove. Nuk ka asnjë element të AAM të mbajtura peng si garanci për huamarrjet me 31 Dhjetor 2021 dhe 2020.

**11. Aktive me të drejtë përdorimi**

(a) Shih shënimin 6 (h).

	Ndertesa	Mjete transporti	Totali
<b>Kosto</b>			
Më 1 janar 2020	22,304,802	8,363,432	30,668,234
Shtesa	10,866,857	21,592,687	32,459,544
Pakësime	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>33,171,659</b>	<b>29,956,119</b>	<b>63,127,778</b>
Shtesa	31,011,878	-	31,011,878
Pakësime	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>64,183,537</b>	<b>29,956,119</b>	<b>94,139,656</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>			
Më 1 janar 2020	(11,152,401)	-	(11,152,401)
Shpenzime të vitit	(11,152,401)	(2,391,763)	(13,544,164)
Pakësime	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(22,304,802)</b>	<b>(2,391,763)</b>	<b>(24,696,565)</b>
Shpenzime të vitit	(10,866,857)	(5,991,238)	(16,858,095)
Pakësime	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(33,171,659)</b>	<b>(8,383,000)</b>	<b>(41,554,659)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>			
Më 1 janar 2020	11,152,401	8,363,432	19,515,833
Më 31 dhjetor 2020	10,866,857	27,564,356	38,431,213
Më 31 dhjetor 2021	31,011,878	21,573,119	52,584,997

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**12. Inventarët**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Mallra për rishitje	576,209,787	544,007,599
Pulla fiskale të akcizës	12,390,485	12,050,206
	<b><u>588,600,272</u></b>	<b><u>556,057,805</u></b>

Më 31 dhjetor 2021, mallrat e gatshëm prej 576,209,787 Lekë (2020: 556,057,805 Lekë) përfshijnë cigare të importuara. të cilat menjëherë pasi importohen, mbahen lokalisht si inventarë.

**13. Të arkëtueshme tregtare**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Llogari tregtare të arkëtueshme	211,476,762	263,571,294
Zbritja - fondi i zhvlerësimit	-	(34,791,575)
Zbritja – fondi i zhvlerësimit për humbjet e pritshme kreditore	(1,407,346)	(365,455)
	<b><u>210,069,415</u></b>	<b><u>228,414,264</u></b>

Të arkëtueshmet tregtare përfshijnë shumat e arkëtueshme nga THG për shitjen e cigareve. Shih shënimin 8 (b) (ii) për detaje të mëtejshme mbi të arkëtueshmet dhe menaxhimin e rrezikut të kredisë.

Shuma 34,791,575 lek në vitin 2020 përbëhet nga zbritja - fondi i zhvlerësimit e njohur për mallrat e dëmtuara që i qenë shitur distributorit dhe marrë mbrapsht përpara shkatërrimit. Shoqëria ishte nën një çështje gjyqësore për rimbursimin e akcizës përkatëse. Malli i dëmtuar është asgjësuar më datë 26.05.2021 në prani dhe miratim të autoriteteve tatimore, doganore, mjedisore dhe bujqësore.

Lëvizja e provizioneve për zhvlerësim në lidhje me të arkëtueshmet tregtare gjatë vitit ishte si më poshtë:

	<b><u>31 dhjetor 2021</u></b>	<b><u>31 dhjetor 2020</u></b>
Balanca më 1 janar	(35,157,030)	(37,212,286)
Zhvlerësimit për vitin	(1,407,346)	(365,455)
Rimarrje e humbjeve kreditore	365,455	2,420,711
Fshirja e fondit të zhvlerësimit	34,791,575	-
<b>Balanca më 31 dhjetor</b>	<b><u>(1,407,346)</u></b>	<b><u>(35,157,030)</u></b>

Njësia ekonomike nuk ka shpалosur një matricë provizioni sepse vlera e llogaritur në fund të vitit nuk konsiderohet materiale.

**14. Aktive të tjera**

	<b><u>2021</u></b>	<b><u>2020</u></b>
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura (shih Shënimin 30)	43,807,381	44,072,860
<b>Aktivët financiarë</b>	<b><u>43,807,381</u></b>	<b><u>44,072,860</u></b>
Parapagime për tatime	52,627,840	68,086,769
Parapagime të tjera	785,168	785,168
<b>Aktive jo-financiare</b>	<b><u>53,413,008</u></b>	<b><u>68,871,937</u></b>
	<b><u>97,220,389</u></b>	<b><u>112,944,798</u></b>

Parapagimet për tatimet përfshijnë shumat të parapaguara autoriteteve doganore dhe për tatimet lidhen kryesisht me TVSH-në.

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**15. Mjete monetare edhe ekuivalente me to**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Llogari rrjedhëse me bankat		
– Në Lek	999,440	15,988,981
– Në Euro	10,343,419	106,088
	<b>11,342,858</b>	<b>16,095,069</b>

Shoqëria ka llogari rrjedhëse në OTP Bank Albania dhe Raiffeisen Bank Albania.

**16. Kapitali aksionar**

	<b>Pronësia</b>	<b>Kapitali aksionar</b>	
		<b>2021</b>	<b>2020</b>
British American Tobacco International Holdings B.V.	100%	552,341,000	552,341,000

Më 31 dhjetor 2021, kapitali aksionar i Shoqërisë është 552,341,000 Lekë (2020: 552,341,000 Lekë) dhe është i ndarë në 552,341 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë secili. Kapitali është plotësisht i paguar.

**17. Të pagueshme tregtare**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (Shënimi 30)	188,004,481	203,905,194
Furnitorë të shërbimeve	8,054,494	15,914,442
Tobacco Holdings Group Shpk	4,497,452	11,373,954
	<b>200,556,426</b>	<b>231,193,590</b>

**18. Detyrimet e qirasë**

Termet dhe kushtet e detyrimeve të papaguara të qirasë më 31 dhjetor 2021 janë si më poshtë.

*Detyrimet e qirasë*

Detyrimet e qirasë më 31 dhjetor 2020 janë të detajuara si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Detyrimi i qirasë për ndërtesa	21,067,905	-
Detyrimi i qirasë për automjetet	16,376,559	22,691,002
<b>Total</b>	<b>37,444,464</b>	<b>22,691,002</b>
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>		
Detyrimi i qirasë për ndërtesa	9,943,973	10,866,857
Detyrimi i qirasë për automjetet	6,513,688	5,093,763
<b>Total</b>	<b>16,457,661</b>	<b>15,960,620</b>
<b>Total</b>	<b>53,902,125</b>	<b>38,651,622</b>
	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Shpenzimet e interesit për detyrimet e qirasë	1,329,316	927,453



**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**19. Detyrime të tjera**

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë të detajuara si më poshtë:

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Shpenzime marketingu të përllogaritura	34,951,878	45,166,784
Detyrime të tjera të shtyra	31,353,826	14,982,647
Të pagueshme ndaj personelit	18,118,427	11,517,851
<b>Detyrime Financiare</b>	<b>84,424,131</b>	<b>71,667,282</b>
Taksa të tjera të pagueshme përveç tatimit në fitim	1,209,400	553,114
<b>Detyrime jo-financiare</b>	<b>1,209,400</b>	<b>553,114</b>
	<b>85,633,531</b>	<b>72,220,396</b>

Detyrimet e përllogaritura janë të lidhura me shpenzimet e kryera por të papaguara ende nga Shoqëria për shërbimet e marketingut të cilat bazohen në kontratat e dakorduara, si dhe detyrime të tjera të përllogaritura administrative që lidhen me TI, shpenzime ligjore dhe shpenzime të tjera të përllogaritura për shlyerjet e mundshme. Të pagueshme ndaj personelit lidhen me shpenzime të përllogaritura për punonjësit në lidhje me lejet vjetore të pamarra dhe shpërblimet.

**20. Provizionet**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Gjendja më 1 janar	74,821,670	73,821,420
Provizionet të njohura gjatë vitit	32,927	1,000,250
Provizionet e rimarra gjatë vitit	(16,392,730)	-
<b>Balanca më 31 dhjetor</b>	<b>58,461,867</b>	<b>74,821,670</b>

Provizionet lidhen me detyrime të mundshme të vlerësuara nga drejtimi. Vlerësimet bazohen në interpretimet e legjislacionit tatimor në fuqi ose që hyjnë në fuqi në fund të periudhës së raportimit, si dhe mbi vendime gjyqësore e të tjera në lidhje me to (shiko Shënimin 29)

**21. Huatë**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Huatë	82,594,175	82,594,175
	<b>82,594,175</b>	<b>82,594,175</b>

Shoqëria ka një linjë kredie me British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited me maturim më 29 maj 2023, me afat 3 vjeçar. Më 1 qershor 2020 British American Tobacco Western Europe Commercial Trading Limited ndryshoi emrin në “British American Tobacco Exports Limited”. Limiti aktual i kredisë në dispozicion është 300,000 mijë lekë dhe një normë interesi të ndryshueshme 3M Bono Thesari Shqiptare + 4.31% në vit dhe tarifë angazhimi prej 1.51% në vit është e pagueshme mbi shumën e patërhequr, neto nga tatimi në burim. Kur afati i huasë përfundon, Shoqëria ose shlyen shumën e principalit të kredisë, ose bën një zgjatje të huasë. Tabela më poshtë tregon një rilloaritje të lëvizjeve të detyrimeve ndaj flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga aktivitetet e financimit.

<i>Shumat në Lek</i>	<b>Hua</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>82,425,267</b>
<i>Ndryshime nga flukset monetare financuese</i>	
Ripagesat neto të huave	-
<b>Ndryshimet totale nga flukset monetare financuese</b>	<b>82,425,267</b>
<b>Ndryshime të tjera</b>	
Shpenzime interesi (shënimi 27)	7,399,862
Interesi i paguar	(7,230,954)
Gjendja më 1 janar 2021	<b>82,594,175</b>
<i>Ndryshime nga flukset monetare financuese</i>	
Ripagesat neto të huave	-
<b>Ndryshimet totale nga flukset monetare financuese</b>	-
<b>Ndryshime të tjera</b>	
Shpenzime interesi (shënimi 27)	8,457,963
Interesi i paguar	(8,457,963)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>82,594,175</b>

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**22. Të ardhurat nga kontratat me klientin**

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Çmimi i publikuar i shitjes me pakicë	5,024,424,373	3,808,679,101
Minus: zbritjet tregtare	(749,105,497)	(599,934,731)
<b>Të ardhurat nga shitjet</b>	<b><u>4,275,318,876</u></b>	<b><u>3,208,744,370</u></b>

Shoqëria njih të ardhurat nga shitja e mallrave në një moment në kohë. Shitjet janë shpalosur në vlerë bruto para zbritjes së kompensimit tregtar dhe vlerës së akcizës, por neto për vlerën e TVSH-së. Sipas ligjit dhe udhëzimeve në fuqi mbi TVSH-në, shitjet e cigareve janë faturuar nga Shoqëria tek Klienti me çmimin përfundimtar të publikuar të shitjes me pakicë, minus çdo komision të ndërmjetëm tregtar, siç janë komisionet e shitjes me shumicë dhe pakicë

**23. Kosto e shitjes**

Kosto e shitjes përbëhet nga:

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Akciza	3,056,497,500	2,305,272,000
Shpenzime të blerjes së cigareve	871,822,623	594,639,428
Shpenzime edhe detyrime të tjera	126,355,734	107,417,432
	<b><u>4,054,675,857</u></b>	<b><u>3,007,328,860</u></b>

Shpenzime edhe detyrime të tjera përbëhen nga detyrime doganore që lidhen me koston e skanimit dhe printimit. Niveli i taksës së akcizës për produktet e duhanit në vitin 2021 është 6500 lek/1000 cigare (2020: 6250 lek/1000 cigare).

**24. Kosto të shpërndarjes**

Shpenzimet sipas natyrës janë prezantuar si më poshtë:

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Shpenzime për tregtimin dhe mbështetjen e markës	38,729,097	43,586,076
Shpenzime personeli	29,985,040	29,279,643
Amortizimi i aktiveve me të drejtën e përdorimit	5,269,881	7,641,620
Udhëtime dhe aktivitete	2,123,589	3,323,968
Të tjera	3,152,921	3,106,166
Shpenzime utilitare dhe të konsumueshme të tjera	657,323	2,234,160
Amortizimi	5,040,235	1,358,845
Shpenzime konsulence, ligjore dhe trajnimi	211,201	21,444
	<b><u>85,169,286</u></b>	<b><u>90,551,922</u></b>

Shpenzimet e tjera tregtare janë për sigurime dhe shpenzime të tjera operative për mirëmbajtje si dhe udhëtime të personelit.

**25. Shpenzime administrative**

Shpenzimet sipas natyrës janë të prezantuara si më poshtë:

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Shpenzime për teknologjinë e informacionit (TI)	41,244,359	47,519,666
Shërbime profesionale	21,838,517	21,101,149
Shpenzime personeli	19,253,976	16,984,988
Shërbime të jashtme	11,698,555	8,846,459
Shpenzime utilitare dhe të konsumueshme të tjera	10,453,128	6,819,953
Amortizimi i aktiveve me të drejtën e përdorimit	5,596,977	5,902,544
Shpenzime të tjera	5,982,003	4,530,004
Udhëtime dhe aktivitete	2,794,262	2,108,374
Shpenzime të auditimit	1,353,682	1,398,301
Shpenzime konsulence, ligjore dhe trajnimi	2,333,821	1,294,461
Amortizimi	1,919,802	918,782
Shpenzim për humbjet nga zhvlerësimi për të arkëtueshmet tregtare	1,041,891	(2,055,256)
	<b><u>125,510,973</u></b>	<b><u>115,369,425</u></b>

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**25. Shpenzime administrative (vazhdim)**

Shpenzimet profesionale janë për shërbime financiare dhe ekzekutive të ofruara nga palë të lidhura dhe shpenzimet për TI lidhen kryesisht me implementimin e një sistemi me bazë SAP-in për planifikimin e burimeve të ndërmarrjes, të integruar me të gjitha entitetet e BAT. Lëvizjet për humbjet nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare shfaqen në shënimin 13.

Në tabelën në vijim janë paraqitur shumat totale të shpenzimeve për kompensimin e punonjësve, të përfshira në shpenzimet e tregtare dhe shpenzimet administrative:

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Pagat	35,345,672	32,263,376
Kontribute për sigurimet Shoqërore dhe shëndetësore	3,907,236	2,950,176
Shpërblime	7,509,198	7,395,993
Të tjera	2,476,910	3,655,086
<b>Totali</b>	<b><u>49,239,015</u></b>	<b><u>46,264,631</u></b>

Deri më 31 dhjetor 2021, Shoqëria ka punësuar 14 punonjës, nga të cilët 13 në role manaxheriale (31 dhjetor 2020: 13 punonjës, nga të cilët 12 në role manaxheriale).

**26. Të ardhura të tjera operative**

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Të ardhura nga shërbimet e rimbursuara (Shënimi 30)	43,825,290	45,518,957
Fitimi neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	861,546	-
Rimarrja e detyrimeve të përllogaritura të periudhave të mëparshme	-	8,634,448
	<b><u>44,686,836</u></b>	<b><u>54,153,405</u></b>

Shpenzimet e rimbursuara lidhen me shpenzimet e bëra në emër të BAT Italy, të cilat më pas rimburohen duke shtuar një rritje prej 8%. Ato lidhen kryesisht me orët e stafit me përvojë të Shoqërisë të caktuara për këtë entitet.

**27. Shpenzimet financiare neto**

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
<b>Fitime financiare</b>		
Interesi i përfituar nga depozitat	27,265	29,888
Fitime nga kursi i këmbimit, neto	-	-
	<b><u>27,265</u></b>	<b><u>29,888</u></b>
<b>Kosto financiare</b>		
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	(3,090,151)	(1,618,652)
Pagesa për garanci bankare	(4,746,200)	(6,189,600)
Kostot e huasë	(8,457,963)	(7,399,862)
Interesi për detyrimet e qirasë	(1,329,316)	(927,453)
	<b><u>(17,623,630)</u></b>	<b><u>(16,135,567)</u></b>
<b>Shpenzime financiare neto</b>	<b><u>(17,596,365)</u></b>	<b><u>(16,105,679)</u></b>

Rezultati i këmbimit valutor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 është i detajuar si më poshtë në baza bruto:

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Fitimet e këmbimit valutor	11,293,533	10,516,793
Humbjet e këmbimit valutor	(14,383,684)	(12,135,445)
<b>Fitimet neto të këmbimit valutor / (humbjet)</b>	<b><u>(3,090,151)</u></b>	<b><u>(1,618,652)</u></b>

**British American Tobacco – Albania Shpk**  
**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

**28. Tatimi mbi fitimin**

	<u>2021</u>	<u>2020</u>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	9,933,203	10,672,494
	<b><u>9,933,203</u></b>	<b><u>10,672,494</u></b>

Shoqëria përcakton tatimin në fund të vitit, sipas legjislacionit tatimor shqiptar. Në vitin 2021, norma e tatimit mbi fitimin në Shqipëri është e barabartë me 15% të rezultatit të tatueshëm (2020: 15%).

Në vijim paraqitet një rakordim midis tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e zbatueshme të tatimit dhe shpenzimit të tatimit mbi fitimin:

	<u>2021</u>		<u>2020</u>	
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>efektive</b>	<b>37,053,230</b>	<b>efektive</b>	<b>33,541,889</b>
Tatimi mbi fitimin me normën prej 15%	15%	5,557,985	15%	5,031,283
Shpenzimet e panjohura	5%	1,890,534	6%	2,044,984
Ndryshimi në diferencat e përkohshme të panjohura	7%	2,484,684	11%	3,596,228
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>27%</b>	<b>9,933,203</b>	<b>32%</b>	<b>10,672,494</b>

Ndryshimi në diferencat e përkohshme të panjohura prej 2,484,684 Lekë (2020: 3,596,228 Lekë) lidhet me shpenzime të caktuara të njohura për qëllime kontabël, por jo për qëllime tatimore. Megjithëse këto shpenzime mund të zbriten nga rezultati tatimor në të ardhmen, Shoqëria nuk ka njohur ndonjë aktiv të shtyrë tatimor në lidhje me to sepse rezultati i kësaj çështjeje është i pasigurt, pasi është subjekt vlerësimesh të ardhshme nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e panjohura prej 12,603,560 lekësh kanë të bëjnë me ato kosto, të cilat sipas ligjit konsiderohen të tilla. Këto shpenzime nuk lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë kryesore të shoqërisë.

**29. Angazhime dhe detyrime të mundshme**

*Çështjet ligjore*

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, mund të ngrihen padi kundër Shoqërisë. Bazuar në vlerësimet e tij, Drejtimi është i mendimit që nuk do të shkaktohen humbje materiale në lidhje me këto padi përtej provizioneve të paraqitura në këto pasqyra financiare (shih shënimin 20).

Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rivlerësohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Provizionet për detyrime dhe tarifa janë detyrime jofinanciare me kohën ose shumë të pasigurt dhe regjistrohen për pozicionet tatimore që përcaktohen nga drejtimi si me më shumë mundësi se sa jo që të rezultojnë në tatime shtesë që do të vendosen nëse pozicionet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë miratuar në mënyrë thelbësore deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo gjykatë e njohur ose aktvendime të tjera për çështje të tilla. Një provizion i tillë njihet bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të kërkuara për shlyerjen e detyrimeve në fund të periudhës raportuese. (shiko Shënimin 20).

*Kontingjentet*

Më poshtë janë paraqitur flukset monetare të paskontuara për shlyerjet e detyrimeve të qirasë sipas vitit të maturimit:

	<u>31 dhjetor 2021</u>
- Më pak se një vit	18,096,274
- Nga një deri në pesë vjet	39,286,518
Mínus shpenzime të interesit në të ardhmen	(3,480,667)
<b>Detyrimi i qirasë financiare</b>	<b><u>53,902,125</u></b>

*Detyrimet të mundshme*

Shoqëria ka marrë dy letra garancie nga Raiffeisen Bank Albania në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave lidhur me detyrime potenciale të ardhshme ndaj kësaj të fundit me një limit total prej 756,600 mijë Lekë. Normat vjetore të interesit pa risk për këto garanci janë 0.7%. Këto garanci do të përdoren në rast se do të lindë një detyrim i ardhshëm. Ato nuk janë përdorur më 31 dhjetor 2021.

## British American Tobacco – Albania Shpk Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### 30. Transaksionet me palët e lidhura

Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse: (a) direkt, ose nëpërmjet një apo më shumë ndërmjetësve, pala:(i) kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën kontrollin e përbashkët me njësinë ekonomike (kjo përfshin Shoqërinë mëmë, filialet dhe nën-filialet); (ii) ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influence të konsiderueshme mbi njësinë; ose (iii) ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike; (b) pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; (c) pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësia ekonomike është një sipërmarrës; (d) pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë apo të Shoqërisë mëmë të saj; (e) pala është një familjar i afërt i ndonjë prej individëve referuar pikës ( a) ose (d); (f) pala është një njësi ekonomike që kontrollohet, bashkëkontrollohet apo me ndikim të rëndësishëm , ose për të cilën ruan fuqinë më të madhe të votimit , direkt apo indirekt për çdo individ të referuar në (d) ose (e); ose (g) pala është një skemë e përfitimit pas – punësimit për përfitimin e punonjësve të njësisë ekonomike, ose të çdo njësie që është palë e lidhur me njësinë ekonomike. Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve, pavarësisht nëse është vënë një çmim. Shoqëria mëmë përfundimtare që ka kontrollin mbi Shoqërinë është British American Tobacco plc, me seli në Londër, Mbretëria e Bashkuar. Shoqëria mëmë është British American Tobacco International Holdings B.V. Hollandë.

Transaksionet me palët e lidhura të Shoqërisë janë si më poshtë:

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
<i>Të arkëtueshme (Shënimi 13)</i>		
BAT Kosovo Shpk	-	-
British American Tobacco Italia S.p.a	43,807,381	44,072,860
	<b>43,807,381</b>	<b>44,072,860</b>
<i>Të pagueshme tregtare (Shënimi 17):</i>		
British American Tobacco Exports Limited	188,004,481	202,989,396
BASS (GSD) Limited	-	915,799
BASS Europe SRL	-	-
	<b>188,004,481</b>	<b>203,905,194</b>
<i>Hua (Shënimi 21)</i>		
British American Tobacco Exports Limited	82,594,175	82,594,175
	<b>82,594,175</b>	<b>82,594,175</b>
<i>Të ardhura te tjera operative (Shënimi 26)</i>		
BAT Kosovo Shpk	-	1,634,929
British American Tobacco Italia S.p.a	43,825,290	43,884,027
	<b>43,825,290</b>	<b>45,518,956</b>
<i>Shpenzime operative</i>		
British American Tabacco Exports Limited	871,822,623	594,639,428
Shpenzime administrative- BASS (GSD) Limited	41,244,359	47,519,666
Shpenzime konsulence, ligjore dhe trajnimi- – BASS Europe SRL, GBS Recruitment	21,838,517	21,101,149
	<b>934,905,498</b>	<b>663,260,243</b>
<i>Kosto financiare( shënimi 27)</i>		
British American Tobacco Exports Limited	(8,457,963)	(7,399,862)

#### Transaksione me drejtimin

Drejtesit kryesorë janë ata persona që kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikim, drejtim dhe kontroll të aktiviteteve të Shoqërisë, drejtpërdrejt ose jo, duke përfshirë Administratorin. Drejtesit kryesorë kanë marrë pagesat e mëposhtme gjatë vitit, të cilat janë përfshirë në shpenzimet administrative dhe tregtare:

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Shpenzime page dhe shpërblime	8,573,223	4,978,568
Kontributet e sigurimeve Shoqërore dhe shëndetësore	521,184	272,090
	<b>9,094,407</b>	<b>5,250,658</b>

### 31. Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni për ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkojë rregullim apo paraqitje në pasqyrat financiare.